

## Fletushkë e Lëvizjes VETËVENDOSJE!

### KËTË JAVË:

- VETËVENDOSJE! ngushëllon popullin turk për sulmet në Stamboll
- VETËVENDOSJE! merr pjesë në Këshillin e Internacionales Socialiste në Gjenevë
- Nga pjesëmarrja e kryetarit Visar Ymeri në forumin ndërkombëtar "Crans Montana"
- Dënojmë shkeljen e territorit dhe vjedhjen tinëzore të Policisë së Malit të Zi
- Kënaqshmëria e qytetarëve me punën e Kryetarit të Komunës dhe Administratës Komunale arrin në 80%

### VETËVENDOSJE! ngushëllon popullin turk për sulmet në Stamboll

Javës që shkoj, Lëvizja VETËVENDOSJE! morri me shqetësim lajmin për shpërthimin tragjik në Aeroportin Ndërkombëtar të Stambollit, ku si pasojë mbetën dhjetëra qytetarë të vdekur dhe të plagosur.

Nëpërmjet një telegrami ngushëllimi Lëvizja u shpreh e tronditur me këto sulme.

"Vrasja e njerëzve të pafajshëm, dhe shkaktimi i frikës në mas, janë krime që duhet dënuar gjithmonë, kudo që ndodhin. Krimet e tilla, si janë monstruoze sa i përket dëmeve e terrorit që shkaktojnë, tregojnë po ashtu për mungesën e kohezionit dhe brishtësinë e shoqërive tona".

"Nuk duhet të pranojmë një shoqëri ku fashizmi, terrorizmi dhe diktaturat kanë ende hapësirë, por për këtë gjë nuk mjafton as ruajtja e status-quo që është terreni i cili ka prodhuar këto fenomene", thuhej në telegram.

### VETËVENDOSJE! merr pjesë në Këshillin e Internacionales Socialiste në Gjenevë

Lëvizja VETËVENDOSJE! u ftua të marrë pjesë në Këshillin e Internacionales Socialiste që u mbajt në Selinë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) në Gjenevë, Zvicër, në datat 1-2 korrik, 2016. Boiken Abazi, Sekretar për Marrëdhënie me Jashtë, e përfaqësoi Lëvizjen në këtë mbledhje të Këshillit të Internacionales.

Në këtë Këshill morën pjesë delegatë nga mbi 90 parti socialdemokrate nga e gjithë bota. Disa prej delegatëve të partive nga Evropa në këtë Këshill përfshinë Partinë Socialiste të Francës, Partinë Socialiste të Belgjikës, Partinë Socialdemokrate të Finlandës, Partinë Socialdemokrate të Hungarisë,

Partinë Socialdemokrate Austriake, Partinë Popullore Republikane të Turqisë, Partinë Socialiste të Spanjës, e shumë parti të tjera nga Amerika Latine, Afrika dhe Azia.



Këshilli u përqendrua në tre tema kryesore: përforsimi i reagimit politik dhe humanitar ndaj sulmeve terroriste dhe konflikteve të armatosura, mbrojtjen dhe mbështetjen e përpjekjeve për demokraci në vende të ndryshme të botës, si dhe përpjekjen për të ndërtuar një model ekonomik që e sfidon dhe e mund pabarazinë ekonomike mes shteteve dhe brenda secilit shtet.

Gjatë Këshillit, Sekretari Abazi pati mundësinë të takohet me dhjetëra delegatë të partive pjesëmarrëse për të prezantuar situatën ekonomiko-politike në Kosovë si dhe programin e VETËVENDOSJE!-s. Më tej, Lëvizja u ftua për të marrë pjesë edhe në Kongresin e Internacionales Socialiste që do të mbahet në fund të këtij viti.

### Nga pjesëmarrja e kryetarit Visar Ymeri në forumin ndërkombëtar "Crans Montana"

Nga data 29 qershor, e deri më 1 korrik, kryetari i Lëvizjes Visar Ymeri ka qëndruar në Vjenë ku ka qenë i ftuar të marrë pjesë në forumin ndërkombëtar "Crans Montana" mbi Evropën Qendrore dhe Evropën e largët Lindore. Forumi u zhvillua nën Patronazhin e Presidentit të Austrisë, dhe në të morën pjesë me qindra përfaqësues qeveritarë, deputetë, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, dhe investitorë të ndryshëm.



Forumu u përqendrua në krijimin dhe forcimin e lidhjeve mes shteteve të Evropës Qendrore dhe Lindore, në zhvillimin e marrëdhënieve ekonomike të secilit shtet, me

### Nr. 469, 06 gusht 2016

qëllim rritjen e bashkëpunimit si dhe të investimeve direkte të huaja.

Gjatë punimeve kryetari Ymeri morri pjesë si diskutues në disa prej sesioneve të mbajtura gjatë Forumit, ku edhe pati rastin të takohet dhe të diskutojë me një numër të pjesëmarrësve.

### Dënojmë shkeljen e territorit dhe vjedhjen tinëzore të Policisë së Malit të Zi

"Ne e dënojmë aktin e policisë malazeze që shkel territorin e shtetit të Kosovës dhe ndërhyrjet tinëzore për të vjedhur tabela mirëseardhjeje dhe flamuj të shtetit tjetër." u tha në komunikatën e Lëvizjes pas aksionit të policisë malazeze.

"Varri i Nuses ndodhet 29 km larg Pejës dhe 18 km larg Rozhajës, si dhe 8 km larg nga pika e kontrollit të policisë së Kosovës e 2 km nga ajo e Malit të Zi. Policia e Kosovës, por edhe Forca e Sigurisë së Kosovës, duhet të shkojnë te Varri Nuses sepse janë të thirrur për ta mbrojtur kufirin e territorit tonë." thuhej në komunikatë ku edhe u paralajmërua se Deputetët do e vendosin sërish tabelën e flamurit atje.

"Nuk do lejojmë ratifikimin e marrëveshjes private të Thaçit me Malin e Zi për demarkacionin e kufirit i cili na i humbet mbi 8.200 hektarë. I ashtuquajturit President Thaçi duhet të përgjigjet për krimin dhe tradhtinë e bërë." thuhej në komunikatë.

### Kënaqshmëria e qytetarëve me punën e Kryetarit të Komunës dhe Administratës Komunale arrin në 80%

Me datë 2 korrik, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) prezantoi rezultatet e anketës lidhur me performancën e pushtetit lokal për regionin e Prishtinës.

Rezultatet e anketës janë pjesë e Mozaikut të Kosovës 2015, si vazhdimësi e raporteve që UNDP-ja i ka filluar në vitin 2003, të cilat pastaj janë realizuar çdo 3 vjet.

Sipas analizës së trendit të kënaqshmërisë me pushtetin lokal, del që Prishtina ka një trend pozitiv që është më i lartë për 22.48 pikë, deri sa në vitin 2012 ishte 7.65 kurse në vitin 2015 është 30.13.

Në raport, performanca e kryetarit të Komunës së Prishtinës është rritur për 11.1% sa ishte 69.9% në vitin 2012. Performanca e Kuvendit Komunal të Prishtinës është rritur për 5% sa ishte 57.5% në vitin 2012. Performanca e administratës komunale është rritur për 22.2% sa ishte 62.2% në vitin 2012.